



Republika e Kosovës – Republic of Kosovo
Komuna – Municipality



04/ 9920 /2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORTI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR MUAJIN NËNTOR 2024

Hani i Elezit, 2024

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Drejtoria për Buxhet dhe Financa për muajin nëntor 2024, funksionin e vet e ka ushtruar në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore mbi qeverisjen e Komunave të Republikës së Kosovës, Statutin e komunës së Hanit të Elezit, Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Ligjin mbi financat e pushtetit lokal, Ligjin mbi vetëqeverisjen lokale, Ligjin mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloret dhe udhëzimet administrative nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Drejtoria për Buxhet dhe Financa me qëllim të realizimit sa më efikas të të gjitha kompetencave dhe përgjegjësi, ka funksionuar kryesisht në katër (4) sektorë:

1. Sektori për buxhet
2. Sektori për financa,
3. Sektori për të hyra dhe
4. Sektori i tatimit në pronë.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa e menaxhuar nga drejtoresha e drejtorisë dhe me një staf prej (7) zyrtarëve, gjatë muajit nëntor kishte një angazhim permanent, me një përkushtim të madh në drejtim të realizimit sa më të suksesshëm të të gjitha objektivave dhe detyrave të parashikuara në planin e punës së drejtorisë. Aktiviteti i drejtorisë ka qenë i përqëndruar në realizimin e buxhetit sipas dinamikës së planifikuar dhe menaxhimin sa më efikas të buxhetit.

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej **3,349,278.00 Euro**.

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim:

- Paga dhe shtesa.....2,075,272.00 €,
- Mallra dhe shërbime.....524,500.00€,
- Shpenzimet komunale93,500.00€,
- Subvencione dhe transfere ...113,000.00 €,
- Shpenzime kapitale543,006.00 €,
- Totali i buxhetit.....3,349,278.00 €.

Punët dhe aktivitetet të cilat janë zhvilluar gjatë këtij muaji, mund t'i veçojmë këto:

SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA

- Përgatitja e raportit mujor të të hyrave dhe shpenzimeve të muajit tetor 2024 dhe publikimi në ueb faqen e Komunës,
- Përgatitja e raportit të punës dhe aktiviteteve të Drejtorisë Buxhet dhe Financa për muajin tetor 2024 dhe dorëzimi i të njëjtit në Kabinetin e Kryetarit si dhe publikimi në ueb faqen e Komunës në formatin PDF dhe Word,
- Deklarimi në Thesar obligimet e pa paguara dhe ato kontraktuale të muajit tetor 2024,
- Barazimi me Thesar për muajin tetor 2024,
- Përgatitja dhe publikimi i borxhit publik për muajin tetor në ueb faqe të Komunës,
- Hartimi i Raportit Financiar Janar-Shtator 2024 dhe publikimi në ueb faqen e Komunës në tri formate: Word, PDF dhe Excel,
- Kam përgatitur dhe përcjell për publikim:
 - Buxhetin e vitit 2025-2027 në dy formate: Word dhe PDF,
 - Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore për vitet 2025-2027: PDF,
 - Tabela 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2025-2027: PDF,
 - Tabela 4.3 Plani Afatmesëm i të hyrave vetanake 2025-2027: PDF,
 - Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjikor: Word dhe PDF,
 - Buxheti 2025-2027 forma Excel me disa anekse,
 - Planifikimi i Investimeve Kapitale 2025-2027: Excel.
- Hartimi i Planit të Prokurimit për vitin 2025,
- Llogaritja dhe realizimi i të gjitha pagesave të destinuar për pagesën e pagave dhe shtesave të Administratës Komunale, të këshilltarëve Komunal, komiteteve të ndryshme të

RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR MUAJIN NËNTOR 2024

Kategoritë Buxhetore	Buxheti sipas Ligjit nr. 08/L-260	Buxheti Final	Realizimi Nëntor 2024	% e Realizimit Nëntor	% Realizimit Janar-Nëntor
Paga dhe Shtesa	2,075,272.00	2,075,272.00	170,554.46	8.2%	94.8 %
Mallra dhe Shërbime	524,500.00	609,154.00	71,255.63	11.6 %	77.6 %
Shpenzime Komunale	93,500.00	93,500.00	6,639.77	7.1 %	76.3 %
Subvencione dhe Transfere	113,000.00	372,795.00	1,920.00	0.5 %	72.1 %
Shpenzime Kapitale	543,006.00	793,899.45	69,816.75	8.7 %	25.4 %
Totali	3,349,278.00	3,944,620.44	320,186.61	8.1 %	75.6 %

Sqarim: Gjatë muajit nëntor kemi hasur në kthim të donacionit në kuadër të kategorisë buxhetore Subvencione dhe Transfere në shumë prej 88,020.00 €. Rrjedhimisht, në buxheti final për këtë kategori buxhetore është përfshirë shuma e cekur pasiqë transferi i kësaj shume është ekzekutuar tek përfituesit më vonë.

SEKTORI PËR TË HYRAT

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2024 është në shumë prej 274,376.00 €. Inkasimi i të hyrave direkte për muajin nëntor është në shumë prej 27,283.36 € dhe paraqesin 9.9% nga projekcioni i të hyrave. Ndërsa, të hyrat direkte të inkasuara për periudhën janar-nëntor janë në shumë prej 212,667.28 € ose 77.5 %. Të hyrat direkte dhe indirekte për periudhën janar-nëntor 2024, janë në shumë prej 262,724.84 €.

Në kuadër të këtij sektori janë kryer këto aktivitete:

- Përpunimi, harmonizimi dhe barazimi i evidencave të detajizuara të të gjitha llojet e të hyrave sipas programeve buxhetore, fondeve dhe kodeve ekonomike në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK),
- Alokimi i të hyrave vetanake në Nën-Programet Buxhetore dhe kategorie buxhetor, varësisht sipas planifikimeve buxhetore,

- Pranimi i raportit të TM3 për të hyrat indirekte nga Divizioni i të Hyrave në shumë prej 19,585.00 €.

SEKTORI I TATIMIT NË PRONË

Gjatë këtij muaji, ky sektor ka pasur këto aktivitete:

- Shërbime të rregullta ndaj qytetarëve.
- Shqyrtimi i ankesave të tatimit në pronë nga Komisioni i ankesave për tatim në pronë,
- Zbritja e normave tatimore për pronat bujqësore, pyjore dhe rezidenciale nga 0.15% në 0.10% në Kuvend Komunal.

Drejtoreshë e Drejtorisë për Buxhet dhe Financa

Lindita Ballazhi

